



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
  
**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



**KRYETARI I KRYEQYTETIT**

16-020/bh-123691/24, më 19 SEP 2024

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

**V E N D I M**

1. **NDALOHET** qarkullimi i mjeteve motorike në rrugën "Fehmi Agani" nga kryqëzimi me rrugën "Migjeni" deri te kryqëzimi me rrugën "UÇK".
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, ndalimi i qarkullimit i mjeteve motorike bëhet në afat të pacaktuar, deri në revokimin e këtij vendimi.
3. Ndalim qarkullimi i mjeteve motorike bëhet nga ora 21:00 deri në orën 02:00.
4. Ndalimi i qarkullimit nuk përfshin mjetet motorike me rëndësi të veçantë dhe mjetet për intervenime të ndryshme nga institucionet kompetente të sigurisë si Policia e Kosovës, inspekcion, automjetet emergjente, si dhe banorët e lagjes.
5. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike që të vendlloj shenjat vertikale përkatëse për ndalimin e qarkullimit, me tabelë plotësuese nga ora 21:00 deri në orën 02:00.
6. Zyra për marrëdhënie me publikun do t'i njoftoj qytetarët dhe subjektet tjera për këtë vendim, përmes mediave të shkruara dhe elektronike.
7. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

**U DORËZOHEȚ:**

- Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim;
- Drejtorisë së Inspekcioit;
- Policisë së Kosovës;
- Zyrës për marrëdhënie me publikun;
- Qendrës për shërbim me qytetar;
- Në dosje.

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**  
**Përparim Rama**